FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.138 14 tetor 2010

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.10 320 datë 23.9.2010	Për ratifikimin e "Marrëveshjes së huasë ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Islamike për Zhvillim (IDB) për pjesëmarrjen në financimin e projektit të rindërtimit të rrugëve dytësore dhe lokale"……	7515
Ligj nr.10 321 datë 23.9.2010	Për ratifikimin e instrumenteve që ndryshojnë Kushtetutën dhe Konventën e Bashkimit Ndërkombëtar të Telekomunikacioneve (Gjenevë, 1992), të ndryshuar nga Konferenca Fuqiplotë (Antalya, 2006)……	7527
Vendim i KM nr.813, datë 13.10.2010	Për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, datë 20.4.2010, për çështjet nr.12315/04 dhe nr.17605/04 "Laska dhe Lika kundër Shqipërisë"……	7540
Udhëzim MPPT nr.22, datë 12.10.2010	Për procedurat e shitjes së objekteve të miratuara për privatizim sipas vendimit nr.676, datë 18.6.2009 të Këshillit të Ministrave "Për kalimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, për Entin Kombëtar të Banesave, të objekteve të ish-Qytetit të Nxënësve, pranë Shkollës së Mesme Teknologjike, Tiranë", vendimit nr.678, datë 18.6.2009 të Këshillit të Ministrave "Për kthimin në fond banesash të disa objekteve të ish-Kombinatit të Tekstileve të Pambukta, në Tiranë, të Ndërmarrjes Mekanike-Tekstili, Tiranë, dhe të ish-Shkollës së Partisë, Tiranë", vendimit nr.708, datë 23.6.2009 të Këshillit të Ministrave "Për kalimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit për Entin Kombëtar të	

Banesave, të objekteve të ish-konviktit dhe të Shkollës Komunale, Tiranë, me qëllim privatizimi", vendimit nr.1285, datë 23.12.2009 të Këshillit të Ministrave "Për kalimin e ish-objektit të kursit të ndërlidhjes së PTT–së, Tiranë, nga ish-Ministria e Ekonomisë dhe Privatizimit, sot Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, për Entin Kombëtar të Banesave, për qëllim privatizimi", vendimit nr.601 datë 23.7.2010 të Këshillit të Ministrave "Për kalim objektesh në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit për Entin Kombëtar të Banesave, të objektit ish-kopshti nr.26, në Tiranë, me qëllim privatizimi"…… 7541

Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Sadetin Sharkiqi…… 7546

LIGJ
Nr. 10 320, datë 23.9.2010

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES SË HUASË NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS ISLAMIKE PËR ZHVILLIM (IDB) PËR PJESËMARRJEN NË FINANCIMIN E PROJEKTIT TË RINDËRTIMIT TË RRUGËVE DYTËSORE DHE LOKALE"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja e huasë ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Islamike për Zhvillim (IDB) për pjesëmarrjen në financimin e projektit të rindërtimit të rrugëve dytësore dhe lokale".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6704, datë 6.10.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

Projekti nr. ALB-0028

MARRËVESHJE HUAJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS ISLAMIKE PËR ZHVILLIM NË CILËSINË E SAJ SI ADMINISTRATORE E FONDIT TË SOLIDARITETIT ISLAMIK PËR ZHVILLIM PËR PJESËMARRJE NË FINANCIMIN E PROJEKTIT TË RINDËRTIMIT TË RRUGËVE DYTËSORE DHE LOKALE

Kjo marrëveshje huaje është lidhur më ___/__/1431 H që i korrespondon __/__/2010 G, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë (në vijim i quajtur "Huamarrësi") dhe Bankës Islamike për Zhvillim, një institucion ndërkombëtar financiar i krijuar sipas neneve të marrëveshjes së nënshkruar/ratifikuar nga shtetet e saj anëtare, me seli në Jeddah, Mbretëria e Arabisë Saudite, në cilësinë e saj si administratore e Fondit Islamik të Solidaritetit për Zhvillim (në vijim e quajtur "Banka" ose "IDB").

Huamarrësi dhe IDB referohen në vijim veçmas si " Palë" dhe bashkërisht si "Palët".

Duke marrë në konsideratë se:

A. Fondi i Solidaritetit Islamik për Zhvillim (në vijim i quajtur " ISFD") është krijuar për qëllim të financimit të projekteve dhe programeve të ndryshme produktive dhe shërbimi që ndihmojnë në uljen e varfërisë në vendet anëtare të Organizatës së Konferencës Islamike, në përputhje me rregullat dhe rregulloret e tij;

B. Një prej qëllimeve të Bankës është të ndihmojë vendet e saj anëtare me anë të huave për financimin e projekteve dhe programeve produktive;

C. Huamarrësi i ka kërkuar Bankës të ndihmojë nëpërmjet pjesëmarrjes në financimin e projektit të rindërtimit të rrugëve dytësore dhe lokale;

D. Projekti (në vijim i quajtur “Projekti”) siç përshkruhet në skedulin II të kësaj Marrëveshjeje me anë të dhënies së huasë, siç parashikohet në vijim;

E. Projekti konsiderohet të jetë teknikisht i qëndrueshëm dhe ekonomikisht i justifikuar;

F. Banka ka rënë dakord ndër të tjera, mbi bazën e sa më sipër, për t’i dhënë një hua Huamarrësit, sipas termave dhe kushteve të përcaktuara në vijim,

rrjedhimisht, palët e kësaj Marrëveshjeje bien dakord si më poshtë.

Neni 1

Përkufizime, kushte të përgjithshme

Seksioni 1.01 Përkufizime: Kurdoherë që përdoren në këtë Marrëveshje, përveç kur konteksti e kërkon ndryshe, disa terma të përkufizuar në kushtet e përgjithshme kanë kuptimet përkatëse të përcaktuara këtu dhe termat e mëposhtëm kanë kuptimet e mëposhtme:

"Disbursimi":	është tërheqja e shumës së huasë.
"Procedura e disbursimit":	është procedura e disbursimit të Bankës.
"Data e hyrjes në fuqi":	është data në të cilën Marrëveshja shpallet në fuqi nga Banka kur i komunikohet Huamarrësit nga Banka.
"Agjencia zbatuese":	është Fondi Shqiptar për Zhvillim (FSHZH), i cili është përgjegjës për zbatimin, operimin dhe menaxhimin e projektit.
“ Konsulenti i projektit”:	është subjekti/personi të cilit i besohet përgatitja e të gjitha skicave të hollësishme, specifikimet teknike, vlerësimi i ndikimit mjedisor dhe preventivat që nevojiten për ndërtimin e rrugëve përkatëse.
“Konsulenti i mbikëqyrjes”:	është subjekti/personi të cilit i besohet mbikëqyrja e punimeve.
“Dokumenti i hollësishëm i planprojektit”:	është dokumenti që mbulon përgatitjen e të gjitha skicave të hollësishme, specifikimeve teknike, vlerësimin e ndikimit mjedisor dhe preventivat që nevojiten për ndërtimin e projektit.
"Kushtet e përgjithshme":	janë kushtet e përgjithshme të zbatueshme për Marrëveshjet e huasë dhe garancisë të Bankës të datës 8.11.1976.
“Dinari islamik/ID”:	siç përcaktohet në nenin 4 (1) (a) të Marrëveshjes që themelon Bankën, është njësia e llogarisë së Bankës. Një ID është i barasvlefshëm me një të Drejtë Speciale Tërheqjeje të Fondit Monetar Ndërkombëtar.
"Shuma e huasë":	është shuma që Banka ka rënë dakord t’i japë hua Huamarrësit, siç përcaktohet në seksionin 2.01 të kësaj Marrëveshjeje.
"Shuma e principalit":	është shuma totale e huasë e tërhequr nga Huamarrësi në pajtim me këtë Marrëveshje.
"Udhëzimet e prokurimit":	janë udhëzimet për prokurimin e mallrave dhe shërbimeve në bazë të financimit të Bankës.
“Projekti" & referencat në "pjesë" të tij:	është projekti dhe pjesë të tij të përshkruara në skedulin I të kësaj Marrëveshjeje.
"Tarifa e shërbimit":	është tarifa e pagueshme nga Huamarrësi për Bankën, siç përcaktohet në seksionin 3.02 të kësaj Marrëveshjeje.
“Punimet”:	punimet ose pjesë të tyre të përshkruara në shtojcën I të kësaj Marrëveshjeje dhe në çdo kontratë përkatëse.

Seksioni 1.02 Kushte të përgjithshme: Palët e kësaj Marrëveshjeje pranojnë të gjitha dispozitat e kushteve të përgjithshme me të njëjtën fuqi dhe efekt sikur të ishin përcaktuar plotësisht në të.

Seksioni 1.03 Në këtë Marrëveshje:

a) Nëse konteksti nuk e kërkon ndryshe, fjalët që tregojnë numrin njëjës përfshijnë shumësin dhe anasjelltas, fjalët që tregojnë personat përfshijnë korporatat dhe partneritetet; dhe referenca ndaj një aneksi, shtojce, neni ose seksioni të caktuar është një referencë ndaj atij aneksi, shtojce, neni ose seksioni të kësaj Marrëveshjeje.

b) Neni dhe titujt e seksionit vendosen vetëm për lehtësi reference dhe nuk përdoren për të përkufizuar, interpretuar ose kufizuar ndonjë prej dispozitave të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 2

Huaja

Seksioni 2.01 IDB i ofron Huamarrësit një hua në një shumë që nuk i kalon 7 000 000/- ID (shtatë milionë dinarë islamikë) (afërsisht të barasvlefshëm me 10 000 000 USD (dhjetë milionë dollarë amerikanë) për pjesëmarrje në financimin e projektit.

Seksioni 2.02 Përveç kur Banka bie dakord ndryshe, kontratat për mallrat dhe shërbimet që duhet të financohen nga shumat e huasë të parashikuara në këtë mënyrë, do të prokurohen në pajtim me udhëzimet e prokurimit. Në këtë drejtim, Huamarrësi do t'u përmbahet rregullave të Organizatës së Konferencës Islamike në lidhje me bojkotin e Izraelit.

Neni 3

Amortizimi, tarifa e shërbimit dhe vendet e pagesave

Seksioni 3.01 Amortizimi: Huamarrësi do ta shlyejë shumën e principalit të huasë nga burimet e ISFD-së për 25 (njëzet e pesë) vjet, duke përfshirë 7 (shtatë) vjet periudhë pa interes që fillon nga data e kësaj Marrëveshjeje, me këste të njëpasnjëshme gjashtëmujore, siç përcaktohet në skedulin I (A) të kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 3.02 Tarifa e shërbimit:

a) Huamarrësi i paguan Bankës një tarifë shërbimi të një shume të llogaritur fillimisht prej ID477 726/- (katërqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e njëzet e gjashtë dinarë islamikë) vetëm sipas mënyrës së përcaktuar në skedulin I (B) të kësaj Marrëveshjeje.

b) Palët pranojnë dhe bien dakord ndërmjet tyre që shuma fillestare e tarifës së shërbimit të përmendur në seksionin 3.02(a) nuk është gjë tjetër veçse një vlerësim i bazuar mbi prezumimin e periudhës së zbatimit dhe periudhës së disbursimit të shumës së plotë të huasë që parashikohet këtu. Më tej, bihet dakord që kjo shumë e tarifës së shërbimit për huanë të llogaritet pas zbatimit të projektit, me kusht që kjo shumë e llogaritur në këtë mënyrë nuk do të kalojë përkatësisht 2.5% (dy pikë pesë për qind) të huasë kur llogaritet mbi bazë vjetore.

c) Tarifa e shërbimit shtohet duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 3.03 Vendet e pagesave: Çdo pagesë, duke përfshirë shlyerjet e shumës së principalit konsiderohet të jetë bërë rregullisht, kur fondet që përfshijnë këto pagesa kreditohen në një llogari të caktuar për këtë qëllim nga Banka.

Seksioni 3.04 Pa cenuar përgjithësimin e dispozitave të seksionit 3.03 të kësaj Marrëveshjeje, çdo pagesë e kryer konsiderohet të jetë bërë rregullisht nëse një nga bankat e mëposhtme i konfirmon Bankës marrjen e kësaj pagese në llogarinë e Bankës:

<u>Nëse një pagesë e tillë bëhet në dollarë amerikanë:</u>
Nr. i llogarisë: GB36SINT60928000159111
Gulf International Bank (UK) Ltd
One Knightsbridge
London SWIX 7XS
United Kingdom
Telex No. 8812261/2
Swift Code: SINTGB2L

Nëse një pagesë e tillë bëhet në sterlina:
Nr. i llogarisë: GB13SINT60928000159137
Gulf International Bank (UK) Ltd
One Knightsbridge
London SWIX 7XS
United Kingdom
Telex No. 8812261/2
Swift Code: SINTGB2L

Nëse një pagesë e tillë bëhet në euro:
Nr. i llogarisë: FR7643899000019696500151088
Union de Banques Arabes et Françaises (UBAF)
92523 Paris, Neuilly Cedex
France
Telex No. 610334 UBAF
Swift Code: UBAFRPPXXX

Seksioni 3.05 Pagesa e vonuar:

1. Nëse ndonjë pagesë bëhet e kërkueshme në datën në të cilën bankat nuk janë të hapura zyrtarisht për punë në vendin ku duhet të bëhet pagesa nga Huamarrësi në monedhën përkatëse, kjo pagesë do të bëhet ditën tjetër të mëpasshme në të cilën bankat janë të hapura për punë.

2. Nëse Huamarrësi nuk arrin të paguajë një shumë të pagueshme si më poshtë, kur është e kërkueshme në përputhje me termat e kësaj Marrëveshjeje, atëherë përveç pagesës së kësaj shume, Huamarrësi do t'i paguajë IDB-së një tarifë pagese të vonuar në lidhje me shumën e vonuar dhe çdo tarifë pagese e vonuar do të llogaritet dhe zbatohet si më poshtë:

a) Një shumë e përcaktuar nga IDB pas aplikimit të formulës së treguar më poshtë:

$$\frac{AxBxC}{360}$$

Ku: "A" nënkupton shumën e papaguar;
"B" nënkupton 1% në vit; dhe
"C" nënkupton numrin e ditëve nga dhe duke përfshirë atë datë dhe datën e kësaj pagese (qoftë para vendimit apo jo).

b) Të gjitha kostot dhe shpenzimet e justifikuara (duke përfshirë pa kufizim, çdo kosto dhe shpenzim ligjor ose të mbledhur të agjentit), të shkaktuar nga IDB si rezultat i vonesës në pagesën për IDB-në.

3. IDB do të paguajë çdo shumë të marrë sipas këtij seksioni për llogarinë e Fondit Waqf IDB pas zbritjes së të gjitha kostove dhe shpenzimeve të shkaktuara nga IDB.

Neni 4
Tërheqjet dhe përdorimi i shumave të huasë

Seksioni 4.01 Tërheqjet: Shuma e huasë e dhënë nga Banka mund të tërhiqet nga Huamarrësi në pajtim me skedulin III dhe dispozitat e tjera të kësaj Marrëveshjeje, kushtet e përgjithshme dhe procedurën e disbursimit, për qëllimet e parashikuara në këtë Marrëveshje, për shpenzimet e bëra në lidhje me koston e arsyeshme të mallrave dhe shërbimeve të kërkuara dhe që duhet të financohen sipas kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 4.02 Data e kërkesës së disbursimit të parë: Nëse brenda 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi ose në një datë të mëvonshme që bihet dakord ndërmjet Huamarrësit dhe Bankës, Huamarrësi nuk ka paraqitur një kërkesë në Bankë për të bërë disbursimin e parë, Banka mund t'i japë fund kësaj Marrëveshjeje duke njoftuar Huamarrësin rregullisht në lidhje me këtë.

Seksioni 4.03 Llogaria e veçantë: Nëse dhe kur është e zbatueshme, një llogari e veçantë në dollarë amerikanë (monedha e huaj) do të hapet pranë një banke të pranueshme për IDB-në për disbursim pa pengesa dhe në kohë të projektit. Me përjashtim të faktit që kufiri maksimal i

disbursimit të rritet në 2.00 milionë U$ (për shkak të volumit të madh të pagesave të vogla që duhet të bëhen shpesh), rinovimi i llogarisë së veçantë dhe çështjet e tjera do të jenë në përputhje me udhëzimet për hapjen e një llogarie të veçantë.

Seksioni 4.04 Data e mbylljes: 31.3.2014 ose një datë e mëvonshme që bihet dakord ndërmjet Huamarrësit dhe Bankës si data e mbylljes së tërheqjes së shumës së huasë për qëllimet e seksionit 6.03(c) të kushteve të përgjithshme. Nëse ndonjë pjesë e shumës së huasë nuk shfrytëzohet deri në datën e mbylljes së disbursimit, Banka mund të anulojë pjesën që nuk është shfrytëzuar deri në atë datë.

Seksioni 4.05 Përdorimi i shumave të huasë: Të gjitha shumat e tërhequra nga Huamarrësi nga llogaria e huasë përdoren vetëm për qëllimet e projektit të financuar nga Banka.

Neni 5
Zbatimi i projektit

Seksioni 5.01 Huamarrësi merr përsipër:

a) Ta zbatojë projektin dhe të zhvillojë operacionet dhe veprimet e tij nëpërmjet Agjencisë Zbatuese me verifikimin dhe efikasitetin e duhur dhe në përputhje me praktikat e qëndrueshme administrative, financiare, inxhinierike dhe ekonomike, nën mbikëqyrjen e drejtuesve dhe personelit të kualifikuar dhe me përvojë dhe me grafikun e financimit, buxhetet, planet dhe specifikimet në lidhje me projektin e paraqitur dhe të miratuar nga Banka;

b) T'i paraqesë Bankës për miratim, sipas hollësirave që mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme nga Banka, çdo modifikim kyç të parashikuar në buxhet, plane dhe specifikime të projektit, si dhe çdo ndryshim thelbësor në secilën kontratë, në përputhje me seksionin 7.02, për shërbimet ose prokurimin e mallrave në lidhje me zbatimin e projektit.

c) T'i paraqesë Bankës një dokument të hollësishëm të projektit brenda 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 5.02 Projekti do të zbatohet brenda një periudhe prej katër (4) vjetësh, duke filluar nga data e disbursimit të parë.

Seksioni 5.03 Pa kufizuar ndonjë nga detyrimet e tjera sipas kësaj Marrëveshjeje, Huamarrësi i lejon Bankës një afat kohor të arsyeshëm për të komentuar mbi çdo ndryshim thelbësor apo shtyrje të afatit të parashikuar në çdo kontratë për shërbimet ose prokurimin e mallrave në lidhje me ekzekutimin e projektit.

Neni 6
Parakushtet shtesë para disbursimit nga Banka

Huamarrësi, nëpërmjet Agjencisë Zbatuese, para paraqitjes së kërkesës së parë për tërheqje, përcakton procedurën që propozon të ndjekë ose merr masa për ndjekjen e kësaj procedure për ofertimin konkurrues, në përputhje me seksionet 2.02 dhe 7.02 të kësaj Marrëveshjeje dhe merr miratimin e Bankës në lidhje me këtë.

Neni 7
Marrëveshje të veçanta

Seksioni 7.01 Huamarrësi vë në dispozicion menjëherë kur të jetë e nevojshme të gjitha shumat, duke përfshirë koston e monedhës lokale dhe tepricat e kostos, të cilat kërkohen për përmbushjen e projektit, sipas termave dhe kushteve të pranueshme për Bankën.

Seksioni 7.02 Përveç kur Banka bie dakord ndryshe, Huamarrësi, nëpërmjet Agjencisë Zbatuese, jep të gjitha kontratat e financuara nga shumat e kësaj huaje për ekzekutimin e projektit, si më poshtë:

i) Ofertimi Konkurrues Kombëtar (OKK) për kontraktuesin e punimeve civile, nga kontraktuesit e kualifikuar dhe në përputhje me procedurat e prokurimit të IDB-së;

ii) Lista e kandidatëve për konsulentë dhe përzgjedhja e konsulentit të projektit nga konsulentët e kualifikuar lokalë, në përputhje me procedurat e prokurimit të IDB-së;

iii) Huamarrësi do të kërkojë miratimin paraprak të Bankës për dhënien e ndonjë kontrate, vlera e së cilës tejkalon shumën e barasvlefshme prej njëqind e pesëdhjetë mijë dinarë islamikë (ID 150 000/-).

Seksioni 7.03 Huamarrësi, nëpërmjet Agjencisë Zbatuese, i jep Bankës menjëherë pas miratimit të tyre nga Huamarrësi, studime, plane dhe specifikime për projektin, grafikun e ekzekutimit të tij dhe çdo ndryshim material të bërë më pas në të, sipas hollësirave të tilla që Banka do të kërkojë herë pas here.

Seksioni 7.04 Huamarrësi, nëpërmjet Agjencisë Zbatuese, krijon dhe mban regjistra të përshtatshëm për të identifikuar mallrat e financuara nga shumat e huasë për të deklaruar përdorimin e tyre në projekt, për të regjistruar progresin e projektit dhe për të reflektuar në pajtim me praktikat e qëndrueshme të kontabilitetit, operacionet dhe gjendjen financiare të Agjencisë Zbatuese.

Seksioni 7.05 Huamarrësi u jep të gjitha mundësitë e arsyeshme përfaqësuesve të akredituar të Bankës për të kryer vizita për qëllimet e lidhura me huanë dhe për të inspektuar projektin, mallrat dhe çdo regjistër dhe dokument përkatës; dhe i jep Bankës të gjithë informacionin që Banka kërkon në mënyrë të arsyeshme në lidhje me shpenzimet nga shumat e huasë, projektin, mallrat dhe operacionet dhe gjendjen financiare të Agjencisë Zbatuese.

Seksioni 7.06 Huamarrësi merr përsipër për qëllimin e zbatimit dhe operimit të projektit, të marrë masat e përshtatshme në mënyrë që Agjencia Zbatuese të funksionojë në çdo rast sipas rregullave dhe rregulloreve në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën dhe të ketë ato kompetenca, drejtim dhe administrim që janë të nevojshme për zbatimin dhe operimin e kujdesshëm dhe efektiv të projektit.

Seksioni 7.07 Huamarrësi, nëpërmjet Agjencisë Zbatuese, garanton ose merr masa për garantimin nga sigurues të mirënjohur të të gjitha mallrave të financuara nga shumat e huasë. Ky sigurim mbulon rreziqet detare, tranzitin ose rreziqe të tjera në lidhje me blerjen dhe importimin e mallrave në territorin e Huamarrësit dhe dorëzimin e tyre në kantierin e projektit, dhe do të mbulojë ato shuma që janë në pajtim me praktikat e qëndrueshme tregtare. Ky sigurim realizohet në pajtim me ligjet e Huamarrësit, me arsyetimin që të ardhurat nga sigurimi do të paguhen në monedhën e kontratës ose në një monedhë lirisht të konvertueshme, në pajtim me udhëzimet e prokurimit.

Seksioni 7.08 Huamarrësi merr të gjitha ato masa që konsiderohen të nevojshme për të vënë në dispozicion, sipas nevojës, të gjithë tokën dhe të drejtat në lidhje me tokën që kërkohen për realizimin e projektit dhe i jep Bankës, me kërkesë të saj, prova të pranueshme për Bankën, që kjo sipërfaqe toke dhe të drejta në lidhje me tokën janë në dispozicion për qëllimet në lidhje me projektin.

Seksioni 7.09 Huamarrësi merr të gjitha ato masa që konsiderohen të nevojshme nga ana e tij për t'i dhënë mundësinë Agjencisë Zbatuese për të zbatuar projektin dhe nuk merr ose nuk lejon marrjen e asnjë mase që do të pengonte ose ndërhynte në zbatimin ose operimin e projektit ose zbatimin e ndonjë prej dispozitave të kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 7.10 Të gjitha dokumentet, regjistrat, korrespondenca me Bankën dhe materialet e ngjashme konsiderohen nga Banka dhe Huamarrësi si konfidenciale.

Seksioni 7.11 Të gjitha taksat, detyrimet, tarifat dhe pagesat në lidhje me financimin nga Banka të projektit mbulohen nga Huamarrësi.

Seksioni 7.12 Huamarrësi është përgjegjës për të dhënë të gjitha fondet që mund të kërkohen për përmbushjen e projektit. E gjithë teprica e kostos do të përballohet nga Huamarrësi.

Seksioni 7.13 Huamarrësi siguron që në zbatimin e projektit, pjesëmarrja e Bankës të konfirmohet, midis masave të tjera, përmes shenjave sinjalistike të afishuara në të gjitha kantieret dhe printimit mbi të gjitha pajisjet, automjetet dhe dokumentet të fjalëve "Projekt i financuar nga Banka Islamike për Zhvillim".

Neni 8
Raportet

Seksioni 8.01

a) Huamarrësi, nëpërmjet Agjencisë Zbatuese dhe Bankës, bashkëpunon plotësisht për të siguruar arritjen e qëllimeve të huasë. Për këtë qëllim, secila prej tyre i jep tjetrës të gjithë atë

informacion që kërkohet në mënyrë të arsyeshme në lidhje me situatën e përgjithshme të huasë. Nga ana e Huamarrësit, ky informacion përfshin informacionin në lidhje me kushtet financiare dhe ekonomike në territor dhe pozicionin e Huamarrësit mbi bilancin e pagesave.

b) Huamarrësi dhe Banka, me kërkesë të një pale, shkëmbejnë herë pas here pikëpamje nëpërmjet përfaqësuesve të tyre në lidhje me çështjet mbi qëllimet e huasë, mirëmbajtjen e shërbimeve të saj dhe përmbushjen nga Huamarrësi të detyrimeve të tij sipas kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 8.02

a) Huamarrësi, nëpërmjet Agjencisë Zbatuese, merr përsipër të sigurojë paraqitjen ose të marrë masa për paraqitjen në Bankë, me pëlqimin e plotë të kësaj të fundit dhe në periudhat e përcaktuara për secilin, të raporteve të mëposhtme:

i) Brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas përfundimit të çdo semestri kalendarik, ose në një periudhë tjetër mbi të cilën palët bien dakord, raporte mbi zbatimin e projektit në atë mënyrë që Banka mund të përcaktojë herë pas here;

ii) Raporte të tjera që Banka mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme në lidhje me investimin e shumave të huasë së disbursuar dhe progresin e projektit;

iii) Menjëherë pas përfundimit të projektit, por në çdo rast jo më vonë se 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditë pas datës së mbylljes ose në një datë të mëvonshme që mund të bihet dakord ndërmjet Huamarrësit dhe Bankës për këtë qëllim, Huamarrësi përgatit dhe i paraqet Bankës një raport përfundimi, me objekt dhe detaje që Banka kërkon në mënyrë të arsyeshme mbi zbatimin dhe operimin fillestar të projektit.

b) Dokumentet e përshkruara në këtë seksion vërtetohen sipas zgjedhjes së Bankës, në atë mënyrë që Banka mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme.

Neni 9
Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje nuk hyn në fuqi deri:

A.

1. Në dhënien e dokumenteve të pranueshme për Bankën që ekzekutimi dhe dorëzimi i kësaj Marrëveshjeje në emër të Huamarrësit është autorizuar ose ratifikuar nga të gjithë rregullatorët e autorizuar për ndjekje ligjore.

2. Kur Huamarrësi të ketë dhënë një opinion ligjor të pranueshëm për Bankën që rrjedh nga një Autoritet Ligjor i Huamarrësit, i cili deklaron se Marrëveshja e huasë është autorizuar dhe nënshkruar siç duhet në emër të Huamarrësit. Deklarata përcakton se Marrëveshja përbën një detyrim të ekzekutueshëm për Huamarrësin, në përputhje me kushtet e saj.

B. Kur një letër autorizimi të jetë lëshuar nga Ministria e Financave ose ndonjë organ tjetër i autorizuar, sipas rregullave të Huamarrësit për Bankën Qendrore ose subjekti që përmbush funksionet e një banke qendrore që udhëzon Bankën Qendrore që pagesa nga Huamarrësi sipas kësaj Marrëveshjeje të huasë dhe kësteve të tarifës së shërbimit të kryhet nga Banka Qendrore ose subjekti që përmbush funksionet e një banke qendrore në datat në të cilat ato bëhen të kërkueshme. Një kopje e letrës së autorizimit, së bashku me një konfirmim nga Banka Qendrore ose subjekti që përmbush funksionet e një banke qendrore që ai ka marrë letrën e lartpërmendur të autorizimit dhe që do të respektojë udhëzimet në përmbajtje të saj, do të paraqiten nga Huamarrësi për Bankën.

Neni 10
Përfundimi i Marrëveshjes për moshyrjen në fuqi

Nëse Marrëveshja nuk do të ketë hyrë në fuqi 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditë nga data e kësaj Marrëveshjeje, Marrëveshja dhe të gjitha detyrimet e palëve sipas saj do të përfundojnë, përveç rasteve kur Banka, pas shqyrtimit të të gjitha shkaqeve të vonesës, cakton një datë të mëvonshme për qëllimin e këtij neni. Banka njofton menjëherë Huamarrësin për këtë datë të mëvonshme.

Neni 11

Ligji rregullues- zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Seksioni 11.01

Kjo Marrëveshje rregullohet dhe interpretohet në përputhje me parimet e Sheriatit Islamik (siç përcaktohet në Standardet e Sheriatit të publikuara nga Organizata e Auditimit dhe Kontabilitetit e Institucioneve Financiare Islamike dhe siç interpretohet nga Akademia e Fiqh Islamik e Organizatës së Konferencës Islamike ose Komiteti i Sheriatit të IDB-së).

Seksioni 11. 02

Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të kësaj Marrëveshjeje dhe çdo pretendim nga ndonjë palë kundër palës tjetër, që lind sipas kësaj Marrëveshjeje, të cilat nuk mund të zgjidhen miqësisht me anë të marrëveshjes së palëve brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve njoftimi nga një palë drejtuar tjetrës, i paraqitet një trupi gjykues arbitrazhi për vendim përfundimtar dhe detyrues, në përputhje me rregullat dhe procedurat e Qendrës Islamike Ndërkombëtare për Pajtim dhe Arbitrazh (IICRA), Dubai në Emiratet e Bashkuara Arabe. Rregullat dhe procedurat e arbitrazhit të IICRA-s zëvendësojnë çdo procedurë tjetër për përcaktimin e mosmarrëveshjeve midis palëve të kësaj Marrëveshjeje ose çdo pretendim nga ndonjë palë kundër palës tjetër, që lind sipas kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 11.03

Nëse brenda 30 (tridhjetë) ditëve pasi kopjet e vendimit t'u jenë dorëzuar palëve, vendimi nuk është i pajtueshëm, çdo palë mund të fillojë një proces gjyqësor ose një procedim për të zbatuar vendimin në ndonjë gjykatë të juridiksionit kompetent kundër palës tjetër, mund të zbatojë vendimin me anë të ekzekutimit ose mund të synojë çdo mjet tjetër të përshtatshëm ligjor kundër palës tjetër për zbatimin e vendimit ose dispozitave të kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 11.05

Çdo palë merr përsipër të ekzekutojë çdo vendim të dhënë sipas kësaj Marrëveshjeje.

Neni 12

Dispozita të ndryshme

Seksioni 12.01 Përfaqësuesit e autorizuar: Ministri i Financave i Huamarrësit dhe çdo person ose persona që ai cakton me shkrim, do të caktohet si përfaqësues i autorizuar i Huamarrësit për qëllimet e seksionit 10.03 të kushteve të përgjithshme.

Seksioni 12.02 Data e Marrëveshjes: Për të gjitha qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, data e Marrëveshjes do të jetë ajo që paraqitet në preambulën e saj.

Seksioni 12.03 Adresat: Adresat e mëposhtme përcaktohen për qëllimet e seksionit 10.01 të kushteve të përgjithshme.

Për Huamarrësin:
Ministria e Financave
Bulevardi Dëshmorët e Kombit, nr. 1
Tiranë, Shqipëri
Tel: +3554228405
Fax: +3554228494
Për Bankën Islamike për Zhvillim:
P.O. Box: 5925
Jeddah - 21432
Kingdom of Saudi Arabia
Tel: +9662636 1400
Fax: +966 26366871

Në dëshmi sa më sipër, Banka dhe Huamarrësi, secili duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesit të tij të autorizuar, e kanë nënshkruar këtë Marrëveshjeje në gjuhën angleze në datën dhe vitin e shkruar më parë më sipër.

SKEDULI-I (A)
SHLYERJET E SHUMËS SË PRINCIPALIT

Këstet	**Datat**	**Këstet e principalit në (ID)**
1.		194,444
2.		194,444
3.		194,444
4.		194,444
5.		194,444
6.		194,444
7.		194,444
8.		194,444
9.		194,444
10.		194,444
11.		194,444
12.		194,444
13.		194,444
14.		194,444
15.		194,444
16.		194,444
17.		194,444
18.		194,444
19.		194,444
20.		194,444
21.		194,444
22.		194,444
23.		194,444
24.		194,444
25.		194,444
26.		194,444
27.		194,444
28.		194,444
29.		194,444
30.		194,444
31.		194,444
32.		194,444
33.		194,444
34.		194,444
35.		194,444
36.		194,460
Totali		**7 000 000**

SKEDULI-I (B)
PAGESAT E TARIFËS SË SHËRBIMIT

Këstet	**Datat**	**Shumat në ID**
1.		19,108
2.		31,848
3.		31,848
4.		31,848
5.		31,848
6.		31,848
7.		31,848
8.		26,753
9.		26,753
10.		26,753
11.		26,753
12.		26,753
13.		26,753
14.		26,753
15.		26,753
16.		26,753
17.		26,753
Totali		**477 726**

SKEDULI-II
PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Objektivi i projektit është përmirësimi i kushteve të jetesës dhe zbutja e varfërisë për banorët në zona të largëta të rrugëve të përmirësuara, duke u siguruar atyre akses në shërbimet bazë, si dhe mundësi ekonomike. Projekti lidh qendrat e popullsisë rurale dhe kontribuon gjithashtu në forcimin e kuadrit institucional për planifikimin, financimin, mirëmbajtjen dhe menaxhimin e rrugëve dytësore dhe lokale në Shqipëri.

Përfshirja e IDB-së në projekt synon të mbulojë rindërtimin e disa segmenteve rrugore, gjatësia e përgjithshme e të cilave është rreth 173 km dhe numri i përfituesve është afërsisht 127 000.

Objekti i projektit mbulon komponentët e mëposhtëm:

A) Punimet civile;

B) Konsulencën e hollësishme të projektit;

C) Konsulencën e mbikëqyrjes;

D) Menaxhimin e projektit;

E) Trajnimin e Njësive të Qeverisë Lokale për Mirëmbajtje;

F) Auditimin financiar;

G) Seminarin fillestar të projektit dhe vizitat njohëse në IDB/HQ.

Financimi i huasë së IDB-së do të përdoret për komponentët e projektit të punimeve civile, konsulencën e hollësishme të projektit, seminarin fillestar të projektit dhe vizitat njohëse.

SKEDULI-III
TËRHEQJA E SHUMAVE TË HUASË

Financimi i IDB-së do të bëhet me anë të huasë që arrin shumën prej 7 000 000 ID. Këto shuma do të përdoren për financimin 100 % të komponentëve të mëposhtëm:

Dollarë amerikanë, në milionë

Nr.	**Përshkrimi i komponentëve**	**Huaja e ISFD-së**	**%**	**QSH**	**%**	**Totali**
1.	Punimet civile	8.17	86	1.28	14	9.45
2.	Konsulenti i projektit të hollësishëm	1.00	100	-	-	1.00
3.	Konsulenti i mbikëqyrjes	-	-	1.20	100	1.20
4.	Menaxhimi i projektit	-	-	1.14	100	1.14
5.	Trajnimi i LGU-së për mirëmbajtje	-	-	0.10	100	0.10
6.	Seminari fillestar i projektit & vizita njohëse	0.03	100	-	-	0.03
7.	Kontrolli financiar	-	-	0.08	100	0.08
Nëntotali		**9.20**	**-**	**3.80**	**-**	**13.00**
Zërat e paparashikuar (5-8%)		0.80	-	0.20	-	1.00
Totali i përgjithshëm		**10.00**	**-**	**4.00**	**-**	**14.00**
Përqindjet		71 %	-	29%	-	100%

LIGJ
Nr.10 321, datë 23.9.2010

PËR RATIFIKIMIN E INSTRUMENTEVE QË NDRYSHOJNË KUSHTETUTËN DHE KONVENTËN E BASHKIMIT NDËRKOMBËTAR TË TELEKOMUNIKACIONEVE (GJENEVË, 1992), TË NDRYSHUAR NGA KONFERENCA FUQIPLOTË (ANTALYA, 2006)

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohen instrumentet që ndryshojnë Kushtetutën dhe Konventën e Bashkimit Ndërkombëtar të Telekomunikacioneve (Gjenevë, 1992), të ndryshuar nga Konferenca Fuqiplotë (Antalya, 2006).

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6705, datë 6.10.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

INSTRUMENTI
QË NDRYSHON KUSHTETUTËN E UNIONIT NDËRKOMBËTAR TË TELEKOMUNIKACIONIT (GJENEVË, 1992) SIPAS MIRATIMEVE TË KONFERENCËS FUQIPLOTË (KJOTO, 1994), KONFERENCËS FUQIPLOTË (MINNEAPOLIS, 1998) DHE KONFERENCËS FUQIPLOTË (MARRAKESH, 2002)

(Ndryshime të miratuara nga Konferenca Fuqiplotë) (Antalia, 2006)

		Faqe
Pjesa I – Parathënie		17
Kapitulli I – Funksionimi i Unionit		
Neni 2	Zgjedhjet dhe çështjet që lidhen me to	18
Neni 4	Këshilli	19
Neni 5	Sekretariati i Përgjithshëm	20
Neni 6	Komiteti koordinues	21
Neni 12	Zyra e radiokomunikimit	21
Neni 15	Zyra e standardizimit të telekomunikacionit	22
Neni 16	Konferencat e zhvillimit të telekomunikacionit	22
Neni 17A	Grupi këshillues i zhvillimit të telekomunikacionit	23
Neni 18	Zyra e zhvillimit të telekomunikacionit	23
Neni 19	Pjesëmarrja e enteve dhe organizatave përveç atyre të administrimit në aktivitetet e Unionit	23
Neni 21	Rekomandime nga një konferencë për tjetrën	24

KAPITULLI II – DISPOZITA TË VEÇANTA LIDHUR ME KONFERENCAT DHE ASAMBLETË

Neni 23 Pranimi në konferencat fuqiplota 25
Neni 24 Pranimi në konferencat e radiokomunikimit 25
Neni 25 Pranimi në asambletë e radiokomunikimit, asambletë e standardizimit të telekomunikacionit botëror dhe konferencat e zhvillimit të telekomunikacionit 26

KAPITULLI IV – DISPOZITA TË TJERA

Neni 33 Financat 27
Pjesa II – Data e hyrjes në fuqi 29
Formula përfundimtare 29
Nënshkrimet 8
Deklaratat dhe vërejtjet 31

Algjeria (Republika Demokratike Popullore e) (59)
Gjermania (Republika Federale e) (40, 51, 73, 98)
Andora (Principata e) (73)
Arabia Saudite (Mbretëria e) (32, 59, 62)
Republika e Argjentinës (18)
Armenia (Republika e) (66)
Australia (72)
Austria (51, 73, 98)
Republika e Azerbajxhanit (66, 73)
Bahrain (Mbretëria e) (19, 59)
Barbados (100)
Bjellorusia (Republika e) (66, 67)
Belgjika (36, 51, 73, 98)
Botsvana (Republika e) (46)
Brazili (Republika Federale e) (27)
Bullgaria (Republika e) (51, 73)
Burgina Faso (102)
Burundi (Republika e) (3)
Kameruni)Republika e) (540)
Kanada (71, 94, 98)
Kili (63)
Kina (Republika Popullore e) (64)
Qipro (Republika e) (51, 73,81,98)
Shteti Qytet i Vatikanit (8, 73)
Kolumbia (Republika e) (58)
Bregu i Fildishtë)Republika e) (24)
Kroacia (Republika (73, 74, 98)
Kuba (80)
Danimarka (51, 73, 98, 106)
Egjipti (Republika Arabe e) (62, 69)
Salvadori (Republika Arabe e) (20)
Emiratet e Bashkuara Arabe (59)
Ekuadori (55)
Spanja (41, 56)
Estonia (Republika e) (51, 61, 73, 98)

Shtetet e Bashkuara të Amerikës (70, 104, 106)
Etiopia (Republika Demokratike Federale) (99)
Federata Ruse (66)
Finlanda (51, 73, 98)
Franca (30, 51, 73, 98, 106)
Republika Gaboneze (16)
Gana (65)
Greqia (51, 73)
Guinea (Republika e) (13)
Guinea Ekuatoriale (Republika e) (85)
Honduras (Republika e) (9)
Hungaria (Republika e), (51, 73, 98)
India (Republika e) (43)
Indonezia (Republika e) (17)
Iran (Republika Islamike e) (59, 78, 79)
Irak (Republika e) (35)
Irlanda (51, 73, 98)
Islanda (33, 73, 98)
Izraeli (Shteti i) (41, 90)
Italia (51, 73)
Xhamajka (97)
Japonia (77, 98, 106)
Jordania (Mbretëria Hashemite e) (21)
Kenia (Republika e) (96)
Korea (Republika e) (88)
Kuvajti (Shteti i) (59, 62, 87)
Letonia (Republika e) (51, 61, 73)
Libani (59, 62)
Lihtenshtajni (Principata e) (33, 73, 98)
Lituania (Republika e) (51, 61, 73)
Luksemburgu (51, 73, 98, 106)
Malejzia (10, 59)
Malavi (44)
Maldivet (Republika e) (22)
Mali (Republika e) (39)
Malta (51, 73, 98)
Maroku (Mbretëria e) (59, 62)
Ishujt Marshall (Republika e) (107)
Mauritania (Republika Islamike e) (103)
Meksika (34)
Mikronezia (Shtetet e Federuara të) (37)
Moldavia (Republika e) (66, 73)
Monako (Principata e) (86)
Mongolia (89)
Mali i Zi (Republika e)
Myanmar (Unioni i) (12)
Nepali (28)
Nikaragua (42)
Nigeria (Republika e) (4)
Nigeria (Republika Federale e) (15)
Norvegjia (33, 73, 98)
Zelanda e Re (83, 98)
Uzbekistani (Republika e) (66)

Pakistani (Republika Islamike e) (48, 59)
Papua Guinea e Re (82)
Paraguai (Republika e) (53)
Holanda (Mbretëria e), (51, 73, 98, 106)
Filipinet (Republika e) (20)
Polonia (Republika e) (23, 51, 73, 98)
Portugalia (38, 51, 73, 98)
Republika Arabe Siriane (57, 59)
Republika Kirgize (66)
Republika Sllovake (50, 51, 73, 98)
Republika Çeke (45, 51, 73, 98)
Rumania (51, 73, 98)
Mbretëria e Bashkuar e Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut (51, 73, 98, 106)
Ruanda (Republika e) (91)
San Marino (Republika e) (7)
Samoa (Shteti i Pavarur i) (92)
Senegali (Republika e) (52)
Serbia (Republika e) (68, 73, 98)
Singapori (Republika e) (31)
Sllovenia (Republika e) (51, 95, 98, 106)
Sudani (Republika e) (59, 76)
Afrika e Jugut (Republika e) (47)
Suedia (51,73, 98, 106)
Zvicra (Konfederata e) (73, 98)
Surinami (Republika e) (5)
Zvaziland (Mbretëria e) (89)
Tanzania (Republika e Bashkuar e) (101)
Çadi (Republika e) (84)
Tajlanda (6)
Republika Togoleze (26)
Trinidadi dhe Tobago (105)
Tunizia (29, 59)
Turqia (60, 73, 93, 98)
Ukraina (66)
Uruguai (Republika lindore e) (1)
Venezuela (Republika Bolivare e) (25)
Vietnami (Republika Socialiste e) (25)
Zimbabve (Republika e) (14)

RREGULLORET E PËRGJITHSHME TË KONFERENCAVE, ASAMBLEVE DHE MBLEDHJEVE TË UNIONIT		95
Kapitulli I	Dispozita të përgjithshme lidhur me konferencat dhe asambletë	97
2	Ftesë për në konferencat e radiokomunikimit kur ekziston një qeveri fituese	97
8	Afatet kohore dhe kushtet për paraqitjen e propozimeve dhe raporteve në konferenca	97
Kapitulli II	Rregulloret e procedurës së konferencave, asambleve dhe mbledhjeve	98
13	Përbërja e komisioneve	98
Kapitulli III	Procedurat e zgjedhjes	100
31	Rregulla të përgjithshme mbi procedurat e zgjedhjeve	100
33	Rregullore të veçanta të procedurës për zgjedhjen e anëtarëve të zyrës së rregulloreve të radios	100
Vendimet		
5 (rishikuar, Antalia 2006)	Të ardhurat dhe shpenzimet e unionit për periudhën 2008-2011	103
9 (Antalia 2006)	Forumi i katërt i politikës botërore të telekomunikacionit	112
10 (Antalia 2006)	Implementimi i masave shtesë korrigjuese lidhur me mbulimin e kostos së regjistrimit të rrjetit satelitor	115
Lista e vendimeve të shfuqizuara nga Konferenca Fuqiplotë (Antalia, 2006)		117
Rezolutat		
11 (Rishikuar, Antalia 2006)	Informacioni/telekomunikacioni botëror dhe rajonal, dhe forumet dhe ekspozitat e teknologjisë së komunikimt	118
14(Rishikuar, Antalia 2006)	Njohja e të drejtave dhe detyrimeve të të gjithë anëtarëve të sektorit të Unionit	123
21(Rishikuar, Antalia 2006)	Masat specifike lidhur me gjetjen e alternativës së procedurave mbi rrjetet e telekomunikacionit ndërkombëtar	125
22(Rishikuar, Antalia 2006)	Ndarja e të ardhurave për sigurimin e shërbimeve ndërkombëtare të telekomunikacionit	129
25(Rishikuar, Antalia 2006)	Forcimi i prezencës rajonale	133
30(Rishikuar, Antalia 2006)	Masat specifike për vendet më pak të zhvilluara dhe vendet e vogla ishullore në zhvillim	144
34(Rishikuar, Antalia 2006)	Asistencë dhe mbështetje për vendet në nevojë të veçantë për rindërtimin e sektorit të tyre të telekomunikacionit	146
36(Rishikuar, Antalia 2006)	Informacion/telekomunikacione dhe teknologji komunikimi në shërbim të ndihmës humanitare	151
41(Rishikuar, Antalia 2006)	Mospagimi në kohën e caktuar dhe llogaritja e tij	154
48(Rishikuar, Antalia 2006)	Menaxhimi dhe zhvillimi i burimeve njerëzore	157
64(Rishikuar, Antalia 2006)	Akses/e drejtë jodiskriminuese kundrejt informacionit/telekomunikacionit modern dhe pajisjeve e shërbimeve të teknologjisë së komunikacionit	163
68(Rishikuar, Antalia 2006)	Dita Botërore e Shoqërisë së Informacionit dhe Telekomunikacionit	166
70(Rishikuar, Antalia 2006)	Tendenca gjinore në ITU/International Telecommunication Union dhe promovimi i barazisë gjinore kundrejt shoqërive gjithëpërfshirëse të informacionit	168
71(Rishikuar, Antalia 2006)	Plani strategjik për unionin për 2008-2011	173
72(Rishikuar, Antalia 2006)	Lidhja e planifikimit strategjik, financiar dhe operacional në ITU/International Telecommunication Union	199
77(Rishikuar, Antalia 2006)	Konferencat, asambletë dhe forumet e Unionit në të ardhmen	202

91(Rishikuar, Antalia 2006)	Mbulimi i kostos për disa produkte dhe shërbime të ITU/International Telecommunication union	204
94(Rishikuar, Antalia 2006)	Auditimi i llogarive të Unionit	209
99(Rishikuar, Antalia 2006)	Statusi i Palestinës në ITU	210
101(Rishikuar, Antalia 2006)	Rrjeti i internetit bazuar në protokoll	214
102(Rishikuar, Antalia 2006)	Roli i ITU lidhur me çështjet e politikës publike ndërkombëtare, përsa i përket internetit dhe menaxhimit të burimeve të tij, përfshirë emrat dhe adresat e fushave	219
111(Rishikuar, Antalia 2006)	Planifikimi i konferencave dhe asambleve të ITU	226
119(Rishikuar, Antalia 2006)	Metodat për përmirësimin e efiçencës dhe efikasitetit të zyrës së rregulloreve të radios	227
122(Rishikuar, Antalia 2006)	Roli zhvillues i asamblesë botërore të standardizimit të telekomunikacionit	230
123(Rishikuar, Antalia 2006)	Lidhja e hendekut të standardizimit ndërmjet vendeve të zhvilluara dhe në zhvillim	235
124(Rishikuar, Antalia 2006)	Mbështetja për partneritetin e ri për zhvillimin e Afrikës	239
126(Rishikuar, Antalia 2006)	Asistencë dhe mbështetje për Republikën e Serbisë për rindërtimin e sistemit të saj publik të transmetimit	244
128(Rishikuar, Antalia 2006)	Mbështetje për programin lidhës në Amerikat dhe planin e veprimit Quito	247
130(Rishikuar, Antalia 2006)	Forcimi i rolit të ITU në ndërtimin e besimit dhe sigurisë në përdorimin e informacionit dhe teknologjive të komunikimit	251
131(Rishikuar, Antalia 2006)	Indeksi i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit dhe treguesit lidhës komunitarë	257
133(Rishikuar, Antalia 2006)	Roli i administratave të vendeve anëtare në menaxhimin e emrave të fushave (shumë gjuhëshe) të ndërkombëtarizuara	262
134 (Antalia, 2006)	Numri i shteteve anëtare të Këshillit	267
135 (Antalia, 2006)	Roli i ITU/International Telecommunication Union në zhvillimin e teknologjive të informacionit/telekomunikacionit dhe komunikimit në sigurimin e asistencës dhe këshillimit kundrejt vendeve në zhvillim dhe në implementimin e projekteve përkatëse kombëtare, rajonale dhe ndërrajonale	269
136(Antalia, 2006)	Përdorimi i teknologjive të informacionit/telekomunikacionit dhe komunikimit për monitorimin dhe menaxhimin në situata emergjence dhe fatkeqësi për paralajmërim, parandalim, lehtësim paraprak	272
137(Antalia, 2006)	Shpërndarja e rrjetit të prodhimit pasues në vendet në zhvillim	277
138(Antalia, 2006)	Simpoziumi Global i Rregulloreve	281
139(Antalia, 2006)	Teknologjitë e informacionit/telekomunikacionit dhe komunikimit për të lidhur hendekun dixhital dhe ndërtuar një shoqëri gjithëpërfshirëse të informacionit	283
140(Antalia, 2006)	Roli i ITU/International Telecommunication Union në implementimin e rezultateve të Samitit Botëror mbi Shoqërinë e Informacionit	290
141(Antalia, 2006)	Studimi mbi pjesëmarrjen e të gjithë aksionarëve përkatës në aktivitetet e Unionit, lidhur me Samitin Botëror mbi Shoqërinë e Informacionit	297
142(Antalia, 2006)	Rishikimi i teknologjisë së përdorur në Kushtetutën dhe Konventën e ITU/International Telecommunication Union	302
143(Antalia, 2006)	Zgjerimi i dispozitave në dokumentacionin e ITU, lidhur me vendet në zhvillim për t'u aplikuar nga vendet me ekonomi në tranzicion	304

144(Antalia, 2006)	Vënia në dispozicion para kohe e modeleve të vendit pritës për konferencat dhe asambletë e Unionit që nuk mbahen në Gjenevë	306
145(Antalia, 2006)	Pjesëmarrja e vëzhguesve në konferencat, asambletë dhe mbledhjet e Unionit	310
146(Antalia, 2006)	Rishikimi i rregulloreve të telekomunikacionit ndërkombëtar	320
147(Antalia, 2006)	Studim mbi menaxhimin dhe funksionimin e Unionit	323
148(Antalia, 2006)	Detyrat dhe funksionet e zëvendëssekretarit të përgjithshëm	327
149(Antalia, 2006)	Studimi i përcaktimeve dhe terminologjisë, lidhur me krijimin e besimit dhe sigurisë në përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit	329
150(Antalia, 2006)	Miratimi i llogarive të Unionit për vitet 2002-2005	331
151(Antalia, 2006)	Implementimi në ITU/International Telecommunication Union i menaxhimit bazuar në rezultate	332
152(Antalia, 2006)	Përmirësimi i menaxhimit dhe rishqyrtimi i mbulimit të shpenzimeve të ITU/International Telecommunication Union nga ana e anëtarëve të sektorit dhe partnerëve	334
153(Antalia, 2006)	Programimi i sesioneve të këshillit dhe konferencave fuqiplotë	337
154(Antalia, 2006)	Përdorimi i të gjashtë gjuhëve zyrtare të Unionit në pozita të barabarta	339
155(Antalia, 2006)	Krijimi i një grupi menaxhimi dhe buxheti të këshillit	343
156(Antalia, 2006)	Programimi i konferencave	345
157(Antalia, 2006)	Forcimi i funksionit të ekzekutimit të projektit në UNT	347
158(Antalia, 2006)	Çështje financiare për t'u marrë në konsideratë nga këshilli	350
159(Antalia, 2006)	Asistencë dhe mbështetje Libanit për rindërtimin e rrjetit të tij të telekomunikacionit (fiks dhe të lëvizshëm)	352
160(Antalia, 2006)	Asistencë për Somalinë	354
161(Antalia, 2006)	Asistencë dhe mbështetje për Republikën Demokratike të Kongos për rindërtimin e rrjetit të telekomunikacionit	357

Lista e rezolutave të shfuqizuara nga Konferenca Fuqiplotë (Antalia, 2006) 359

INSTRUMENTET QË PËRMIRËSOJNË
KUSHTETUTËN DHE KONVENTËN E UNIONIT NDËRKOMBËTAR TË TELEKOMUNIKACIONIT
(GJENEVË, 1992)
Të amenduara nga
Konferenca Fuqiplotë (Kyoto, 1994),
Konferenca Fuqiplotë (Minneapolis, 1998)
dhe nga Konferenca Fuqiplotë (Marrakesh, 2002)

(Amendamente të miratuara nga Konferenca Fuqiplotë (Antalia, 2006)

KUSHTETUTA E UNIONIT NDËRKOMBËTAR TË TELEKOMUNIKACIONIT*
(GJENEVË, 1992)

PJESA I
PARATHËNIE

Mbështetur në përmirësimin e dispozitave të Konventës së Unionit Ndërkombëtar të Telekomunikacionit (Gjenevë, 1992), sipas amendamenteve të Konferencës Fuqiplotë (Kyoto, 1994), Konferencës Fuqiplotë (Minneapolis, 1998) dhe Konferencës Fuqiplotë (Marrakesh, 2002), veçanërisht amendamentet e nenit 42 të saj, Konferenca Fuqiplotë e Unionit Ndërkombëtar të Telekomunikacionit (Antalia, 2006) ka miratuar amendamentet e mëposhtme përsa i përket Konventës në fjalë:

CS/Neni 11

KAPITULLI I
DISPOZITA THEMELORE

Neni 11
Sekretariati i Përgjithshëm

ADD* 73bis Sekretariati i Përgjithshëm do të veprojë si përfaqësues ligjor i Unionit.
SUP* 76

CS/Neni 13

KAPITULLI II
SEKTORI I RADIOKOMUNIKIMIT

Neni 13
Konferencat e radiokomunikimit dhe asambletë e radiokomunikimit

MOD 90 PP-98 2. Konferencat botërore të radiokomunikimit do të zhvillohen normalisht çdo tre –katër vjet; megjithatë, pas aplikimit të dispozitave përkatëse të Konventës, nuk nevojitet të zhvillohet një konferencë e tillë ose mund të zhvillohet një konferencë shtesë.

MOD 91 PP-98 3. Asambletë e radiokomunikimit do të mblidhen normalisht çdo tre-katër vjet dhe duhet të shoqërohen në vendin dhe kohën e konferencave botërore të radiokomunikimit, në mënyrë që të përmirësojnë efiçencën dhe efektivitetin e sektorit të radiokomunikimit. Asambletë e radiokomunikimit duhet të sigurojnë bazën e nevojshme teknike për punën e konferencave botërore të radiokomunikimit dhe t'u përgjigjen të gjitha kërkesave të konferencave botërore të radiokomunikimit. Detyrat e asambleve të radiokomunikimit specifikohen në Konventë.

* Gjuha e përdorur në instrumentet bazë të Unionit (Kushtetuta dhe Konventa) do të konsiderohet asnjanëse përsa i përket gjinisë.

KAPITULLI V
DISPOZITA TË TJERA NË LIDHJE ME FUNKSIONIMIN E UNIONIT

Neni 28
Financat e Unionit

MOD 161C PP-98 2. Sekretariati i Përgjithshëm informon shtetet anëtare dhe anëtarët e sektorit për shumën e parashikuar të njësisë kontribuese, siç është përcaktuar në nr.161B më sipër dhe fton shtetet anëtare që të njoftojnë jo më vonë se katër javë para datës së caktuar për hapjen e Konferencës Fuqiplotë, kategorinë e kontributit që ata kanë zgjedhur paraprakisht.

MOD 161E PP-98 PP-02 4. Mbështetur në draftin e planit financiar të rishikuar, sa më shpejt që të jetë e mundur, konferenca fuqiplotë përcakton kufirin më të lartë të shumës për njësinë kontribuese dhe cakton datën e cila duhet të jetë maksimumi dita e hënë e javës së fundit të punimeve të Konferencës Fuqiplotë, në të cilën shtetet anëtare, në bazë të ftesës së bërë nga Sekretariati i Përgjithshëm, duhet të njoftojnë zgjedhjen e tyre përfundimtare të kategorisë së kontribuimit.

Neni 29
Gjuhët

MOD 171 1 1. Gjuhët zyrtare të unionit do të jenë arabisht, gjuha kineze, anglisht, frëngjisht, rusisht dhe spanjisht.

PJESA II
DATA E HYRJES NË FUQI

Amendamentet e përfshira në këtë instrument duhet të hyjnë në fuqi më 1 janar 2008 mes shteteve anëtare, të cilat do të jenë në atë periudhë pjesë e Kushtetutës dhe Konventës së Unionit Ndërkombëtar të Telekomunikacionit (Gjenevë, 1992), dhe duke depozituar para asaj date instrumentin e tyre të ratifikimit, pranimit apo miratimit ose aderimit në instrumentin aktual amendues.

Në dëshmi sa më sipër, të plotfuqishmit përkatës kanë nënshkruar origjinalin e këtij instrumenti që përmirëson Kushtetutën e Unionit Ndërkombëtar të Telekomunikacionit (Gjenevë, 1992), të amenduar nga Konferenca Fuqiplotë (Kyoto, 1994), Konferenca Fuqiplotë (Minneapolis, 1998) dhe nga Konferenca Fuqiplotë (Marrakesh, 2002).

Bërë në Antalia, më 24 nëntor 2006.

Për Afganistanin
BARYALAI HASSAM
AJMAL AYAN

Për Shqipërinë
ARIAN SINOIMERI

Për Republikën Demokratike Popullore të Algjerisë
SMAIL ALLAOUA

Për Republikën Federale të Gjermanisë
WILHELM ESCHWEILER

Për Republikën Argjentinase
SERGIO SCARABINO
ANTONIO ERMESTE CRISTIANI
JUAN FACUNDO FERNANDES BEGNI

Për Republikën e Armenisë
ALBERT NALBANDIAN

Për Australinë
COLIN LAWRENCE OLIVER
JASON CAMPBELL ASHURST

Për Austrinë
CHRISTIAN SINGER
SUSANA WOLFER

Për Andorën
JAUME SALVAT FONT

Për Angolën
VIRGILIO MARQUES DE FARIA

Për Mbretërinë e Arabisë Saudite
MOHAMMED JAMIL A. MULLA
FAREED Y. KHASHOGGI
SAMI AL-BASHEER
HAREEB K.AL SHANKITI

Për Barbadosin
NATALIE BURKE

Për Republikën e Bjellorusisë
IVAN RAK

Për Belgjikën
GUIDO POUILLON

Për Republikën e Beninit
GHABI BOUBAKAR O.ABOUBAKAR
Për Mbretërinë e Butanit
TENZIN CHHOEDA

Për Bosnjë dhe Hercegovinën
ZELJKO KNEZEVIC

Për Republikën e Botsvanës
CUTHBERT M. LEKAUKAU
PHOENG OABITSA TAMASIGA
TEBOGO TAU
TSHOGANETSO KEPALETSWE
AARON T. NYELESI

Për Republikën Federative të Brazilit
PLINIO de AGUIAR JUNIOR
JOAU CARLOS FAGUNDES ALBERNAZ

Për Brunei Darusalam
HAIRUL MOHD DAUD ABDUL KARIM

Për Republikën e Bullgarisë
DIMITAR STANCHEV
PETKO KANTCHEV

Për Burkina Fason
JACQUES A.LOUARI

Për Republikën e Azerbajxhanit
ALI ABBASOV
AYAZ BAYRAMOV

Për Mbretërinë e Bahreinit
S.M.BIN KHALIFA AL-KHALIFA

Për Republikën Popullore të Bangladeshit
REZAKUL HAIDER

Për Kanadanë
BRUCE A.GRACIE
WILIAM R.GRAHAM

Për Republikën e Kepit të Gjelbër
DAVID GOMEZ

Për Republikën e Afrikës Qendrore
VALERI SAI
JUSTIN GOURNA-ZACKO

Për Kilin
GONZALO NAVARRO CABRERA
Për Republikën Popullore të Kinës
YONGHONG ZHAO

Për Republikën e Qipros
GEORGIOS KOMODROMOS
ANTONIS ANTONIADES

Për Qytet-Shtetin e Vatikanit
SANDRO PIER VENANZI

Për Republikën e Kolumbisë
JOAQUIN GABRIEL RESTREPO
FRANKLIN MERCHAN CALDERON

Për Unionin e Komoros
ALI MOHAMED ABDALLAH
AHMED ABDOU

Për Republikën e Kongos
AKOUALA AKOUALA

Për Republikën e Koresë
SEONG-CHUL KANG

Për Republikën e Burundit
MARIE GORETH NIZIGAMA

Për Mbretërinë e Kamboxhias
NARATH LAR

Për Republikën e Kamerunit
ISMAILA MOUCHILI
JEAN PIERRE BIYIT BI ESSAM

Për Republikën e Kroacisë
DRAZEN BREGLEC
KRESO ANTONOVIC

Për Kubën
RAMON LINARES TORRES
KARLOS MARTINEZ ALBUERNE
ADGAR ERMOS CRESPO

Për Danimarkën
HENRIK KJAER
KIRSTEN BAK
LASSE HOM GROENNING

Për Republikën Domenikane
CLAUDIA ACRA

Për Republikën Arabe të Egjiptit
AMRA HASHEM

Për Republikën e Salvadorit
MIGUEL ANGEL ALCAINE
SAUL VASQUEZ GONZALES

Për Emiratet e Bashkuara Arabe
TARIQ AL AWADHI
ABDULRIDA ASKER
ABDULAZIZ BAWAZEER

Për Ekuadorin
JOSE VIVANCO ARIAS
GERMAN CELLERI

Për Kosta Rikën
PEDRO PABLO UQIROS CORTES

Për Republikën e Bregut të Fildishtë
JEAN BAPTISTE YAO KOUAKOU
ALEXIS KOFFI KOUMAN
FELIX NANIHIO

Për Republikën Federale Demokratike të Etiopisë
MULATO TESHOME

Për Federatën Ruse
LEONID D.REMAIN

Për Finlandën
OLLI MATTILA

Për Francën
GILLES CHOURAQUI

Për Republikën Gaboneze
CLOTAIRE ELANGMANE
WILLIAM MOUNGALA
STANISLAS OKOUMA LEKHOUYI
JACQUES EDANE NIKWELE
FABIEN MBENG EKHOGA
ROGER YVES GRANDET
JEAN-JACQUES MASSIMA-LANDJI

Për Republikën e Gambias
YUSUPHA DIBBA
YANKUBA TOURE
OMAR P.NDOU
PHODAY SISAY
EBOY CEESAY
EBRIMA BANDEH

Për Gjeorgjinë
DAVID TSIKLAURI
MIKHEIL GOTOSHIA

Për Ganën
BENJAMIN AGGERY NTIM

Për Greqinë
NISSIM BENMAYOR
VASSILIS CASSAPOGLOU

Për Spanjën
LUIS SANZ GADEA
BLANCA GONZALES GONZALES
MANUEL ZARAGOZA MIFSUD

Për Republikën e Estonisë
TONU NIRK

Për Shtetet e Bashkuara të Amerikës
DAVID A.GROSS
RICHARD C.BEAIRD

Për Republikën e Guinesë
ALPHA OUMAR BALDE
MAMADOU DIOULDE SOU
MOHAMED SYLLA
ABDOULAYE KEBE

Për Republikën e Guinesë Ekuatoriale
MELCHOR EFUA MOKUIY

Për Islandën
ARI JOHANNSSON

Për Republikën e Hondurasit
JOSE MIGUEL PAZ IZAGUIRRE

Për Republikën e Hungarisë
FERENC NORVATH
PETER VARI

Për Republikën e Indisë
P.K.GARG
ASHOK CHANDRA
R.N.JHA

Për Republikën e Indonezisë
IKHSAN BAIDIRUS

Për Republikën Islamike të Iranit
AHMAD POURANGINIA
Për Republikën e Irakut
MOHAMMED SALMAN AL HAMADANY
WEQAR ALI ZEIN

Për Republikën e Guatemalës
OSCAR CHINCILLA GUZMAN
IBRAHIMA KENDA SOUARE
HABIB TALL

Për Xhamajkën
J. PAUL MORGAN

Për Japoninë
TOMOYUKI ABE

Për Mbretërinë Hashemite të Jordanisë
AFRAM JAMAL-DENIAN

Për Republikën e Kenias
BITANGE NDEMO
FELIX MUGABE
JOHN OMO

Për shtetin e Kuvaitit
HAMEED ALQATTAN
HEND AL MASOUD
SALEH KHALAF

Për Republikën Popullore Demokratike të Laosit
PHOMMATANSY PALAMI

Për Mbretërinë e Lesotos
TSELISO MOKELA
TLALI MANOSA

Për Republikën e Letonisë
RAIMONDS BERGMANIS

Për Jamahirija Arabe Popullore Socialiste të Libisë
MARWAN HAMADE
ABDUL-MUNHEM YOUSSEF
MAURICE GHAZAL

Për Principatën e Lihtenshtejnit
KURT BUHLER
Për Republikën e Lituanisë
SALAUSKAS VALDEMRAS

Për Irlandën
CAOIMHIN SMITH

Për Republikën e Madagaskarit
MARCEL AIME

Për Malajzinë
AMARJIT S.K.SINGH

Për Malavin
MIKE KUNTIYA
BERSON LIJENDA
FUMBANI SICHINGA
NELLIE NSEULA

Për Republikën e Maldiveve
MOHAMED AMIR
ILYAS AHMED

Për Republikën e Malit
ADAMA KONATE
IDRISSA SAMAKE
DIADIE TOURE
COULIBALY FATIMATA

Për Maltën
IVAN BUGESA

Për Mbretërinë e Marokut
HASSAN LEBBADI

Për Republikën e Ishujve Marshall
DAVID A.GROSS

Për shtetin e Izraelit
MOSHE GALILI
LIAT GLAZER

Për Italinë
CARMELO BASSO

Për Republikën Islamike të Mauritanisë
MOHAMED ELKORY OULD CHEINE

Për Meksikën
REINALDO GONZALES BUSTAMANTE
LEONEL LOPEZ CELAYA

Për Shtetet e Federuara të Mikronezisë
SHARON D.JAHN

Për Luksemburgun
ANNE BLAU

Për Republikën e Moldavisë
PAVEL BUCEATCHI

Për Principatën e Monakos
ROBERT FILLON

Për Mongolinë
SAIKHANBILEG CHIMED

Për Republikën e Malit të Zi
JOVANOVIC DEJAN

Për Republikën e Mozambikut
LUIS JOSE REGO
JULIO BOUQUE DE MIRANDA

Për Unionin e Mjanmarit
TIN HTWE
KHIN MAUNG THET

Për Republikën e Namibisë
HENRI KASSEN

Për Nepalin
ANANDA RAJ KHANAL

Për Nikaraguan
PABLO DE LA ROCA

VENDIM
Nr.813, datë 13.10.2010

PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT TË GJYKATËS EUROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT, DATË 20.4.2010, PËR ÇËSHTJET NR.12315/04 DHE NR.17605/04 "LASKA DHE LIKA KUNDËR SHQIPËRISË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 46 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, ratifikuar me ligjin nr.8137, datë 31.7.1996 "Për ratifikimin e konventës europiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore", të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" dhe të nenit 13 të ligjit nr.10 190, datë 2.11.2009 "Për buxhetin e vitit 2010", me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, datë 20.4.2010, për çështjet nr.12315/04 dhe nr.17605/04 "Laska dhe Lika kundër Shqipërisë", në shumën 4 800 (katër mijë e tetëqind) euro, për secilin ankues, si dhe pagesën e tatimit mbi të ardhurat për dëmshpërblimin, në masën 10 për qind të kësaj shume.

2. Autoriteti përgjegjës për ekzekutimin e këtij vendimi është Ministria e Financave dhe afati për kryerjen e ekzekutimit është data 20.10.2010.

3. Efekti financiar, i parashikuar në pikën 1 të këtij vendimi të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.

4. Shuma e përcaktuar si detyrim në pikën 1 të këtij vendimi të depozitohet në një nga bankat e nivelit të dytë, në emër të secilit prej ankuesve, z.Vladimir Laska dhe z.Artur Lika, dhe të konvertohet në lekë me kursin e këmbimit të bankës, ku është depozituar shuma, në datën e kryerjes së pagesës.

5. Pagimi i shumës së depozituar, sipas pikës 4 të këtij vendimi, në favor të ankuesve z.Vladimir Laska dhe z.Artur Lika, të bëhet nga Ministria e Financave pas paraqitjes së të gjithë dokumentacionit ligjor të nevojshëm për kryerjen e pagesave nga Buxheti i Shtetit.

6. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

UDHËZIM
Nr.22, datë 12.10.2010

PËR PROCEDURAT E SHITJES SË OBJEKTEVE TË MIRATUARA PËR PRIVATIZIM SIPAS VENDIMIT NR.676, DATË 18.6.2009 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR KALIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT, NGA MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS MINISTRISË SË PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT, PËR ENTIN KOMBËTAR TË BANESAVE, TË OBJEKTEVE TË ISH-QYTETIT TË NXËNËSVE, PRANË SHKOLLËS SË MESME TEKNOLOGJIKE, TIRANË", VENDIMIT NR.678, DATË 18.6.2009 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR KTHIMIN NË FOND BANESASH TË DISA OBJEKTEVE TË ISH-KOMBINATIT TË TEKSTILEVE TË PAMBUKTA, NË TIRANË, TË NDËRMARRJES MEKANIKE-TEKSTILI, TIRANË, DHE TË ISH-SHKOLLËS SË PARTISË, TIRANË", VENDIMIT NR.708, DATË 23.6.2009 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR KALIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT, NGA MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS MINISTRISË SË PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT PËR ENTIN KOMBËTAR TË BANESAVE, TË OBJEKTEVE TË ISH-KONVIKTIT DHE TË SHKOLLËS KOMUNALE, TIRANË, ME QËLLIM PRIVATIZIMI", VENDIMIT NR.1285, DATË 23.12.2009 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR KALIMIN E ISH-OBJEKTIT TË KURSIT TË NDËRLIDHJES SË PTT–SË, TIRANË, NGA ISH-MINISTRIA E EKONOMISË DHE PRIVATIZIMIT, SOT MINISTRIA E EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS, NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT, PËR ENTIN KOMBËTAR TË BANESAVE, PËR QËLLIM PRIVATIZIMI", VENDIMIT NR.601 DATË 23.7.2010 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR KALIM OBJEKTESH NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT PËR ENTIN KOMBËTAR TË BANESAVE, TË OBJEKTIT ISH KOPSHTI NR.26, NË TIRANË, ME QËLLIM PRIVATIZIMI"

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të ligjit nr.9232 datë 13.5.2004 "Për programet sociale të strehimit në zonat urbane", të ndryshuar, të pikave 2, 3 dhe 4 të vendimit nr.676 datë 18.6.2009 të Këshillit të Ministrave "Për kalimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, për Entin Kombëtar të Banesave, të objekteve të ish-Qytetit të Nxënësve, pranë Shkollës së Mesme Teknologjike, Tiranë," pikave 2, 3 dhe 4 të vendimit nr.678, datë 18.6.2009 të Këshillit të Ministrave "Për kthimin në fond banesash të disa objekteve të ish-Kombinatit të Tekstileve të Pambukta, në Tiranë, të Ndërmarrjes Mekanike-Tekstili Tiranë, dhe të ish-Shkollës së Partisë, Tiranë", pikave 2 e 3 të vendimit nr.708, datë 23.06.2009 të Këshillit të Ministrave "Për kalimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit për Entin Kombëtar të Banesave, të objekteve të ish-konviktit dhe të shkollës Komunale, Tiranë, me qëllim privatizimi", pikave 2 e 3 të vendimit nr.1285, datë 23.12.2009 të Këshillit të Ministrave "Për kalimin e ish-objektit të kursit të ndërlidhjes së PTT–së, Tiranë, nga ish-Ministria e Ekonomisë dhe Privatizimit, sot Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, për Entin Kombëtar të Banesave, për qëllim privatizimi", të pikave 2 e 3 të vendimit nr.601 datë 23.7.2010 të Këshillit Ministrave "Për kalim objektesh në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit për Entin Kombëtar të Banesave, të objektit ish-kopshti nr.26, në Tiranë, me qëllim privatizimi", Ministri i Punëve Publike dhe Transportit

UDHËZON:

1 Regjistrimi i banesave për privatizim dhe terminologjia e përdorur.

1.1. E gjithë procedura për regjistrimin e objekteve të kthyera në banesa me aktet: vendimi nr.676, datë 18.6.2009 i Këshillit të Ministrave "Për kalimin e përgjegjësisë së administrimit, nga

Ministria e Arsimit dhe Shkencës Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, për Entin Kombëtar të Banesave, të objekteve të ish-Qytetit të Nxënësve, pranë Shkollës së Mesme Teknologjike, Tiranë," të vendimit nr.678, datë 18.6.2009 të Këshillit të Ministrave "Për kthimin në fond banesash të disa objekteve të ish-Kombinatit të Tekstileve të Pambukta, në Tiranë, të ndërmarrjes Mekanike-Tekstili, Tiranë dhe të ish-Shkollës së Partisë, Tiranë", vendimi nr.708, datë 23.6.2009 i Këshillit të Ministrave "Për kalimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit për Entin Kombëtar të Banesave, të objekteve të ish-konviktit dhe të Shkollës Komunale, Tiranë, me qëllim privatizimi", vendimi nr.1285, datë 23.12.2009 i Këshillit të Ministrave "Për kalimin e ish-objektit të kursit të ndërlidhjes së PTT–së, Tiranë, nga ish-Ministria e Ekonomisë dhe Privatizimit, sot Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, për Entin Kombëtar të Banesave, për qëllim privatizimi", vendimi nr.601, datë 23.7.2010 të Këshillit të Ministrave "Për kalim objektesh në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit për Entin Kombëtar të Banesave, të objektit ish-kopshti nr.26, në Tiranë, me qëllim privatizimi", në vijim referuar në kuptim të këtij udhëzimi, të gjitha vendimet e Këshillit të Ministrave të sipërcituara shkurtimisht si "Aktet respektive", të kryhet për kalimin në pronësi të Entit Kombëtar të Banesave nga Enti Kombëtar i Banesave kundrejt dokumentacionit të kërkuar nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë sipas ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi.

2. Procedura e kalimit të objekteve qytetarëve

2.1 Procedura e kalimit (privatizim) të objekteve të miratuara për privatizim sipas akteve respektive të kryhet nga Enti Kombëtar i Banesave në emër të qytetarëve që kanë emrin në listat bashkëlidhur akteve respektive dhe pasi të jenë regjistruar në pronësi të Entit Kombëtar të Banesave.

2.2 Kur personat që banojnë në këto objekte, nuk janë përfshirë në listat e miratuara në aktet respektive, lidhja e kontratave të kryhet me personat e evidentuar nga EKB që banojnë në këto mjedise dhe të konfirmuar nga organet e qeverisjes vendore.

3. Dokumentacioni i kërkuar nga Enti

3.1 Dokumentacioni që duhet të paraqesin qytetarët pranë Entit Kombëtar të Banesave duhet të përmbajë:

a) Kërkesë me shkrim e qytetarit për privatizimin e apartamentit të miratuar;

b) Certifikatë e gjendjes familjare në ditën e miratimit apo hyrjes në fuqi të botimit në Qendrën e Publikimeve Zyrtare të aktit respektiv përkatës, respektivisht si vijon:

- Banorët e objekteve të ish-Qytetit të Nxënësve, pranë shkollës së Mesme Teknologjike, Tiranë, të datës 18.6.2009;

- Banorët e disa objekteve, respektivisht, të ish-Kombinatit të Tekstileve të Pambukta, në Tiranë, të Ndërmarrjes Mekanike-Tekstili, Tiranë, dhe të ish-Shkollës së Partisë, Tiranë, të datës 18.6.2009;

- Banorët e objekteve të ish-konviktit dhe të Shkollës Komunale, Tiranë, të datës 23.6.2009.

- Banorët e ish-objektit të kursit të ndërlidhjes së PTT–së, Tiranë, të datës 23.12.2009.

- Banorët e objektit ish-kopshti nr.26, në Tiranë, të datës së publikimit të këtij akti në Fletoren Zyrtare.

3.2 Për efekt të zbatimit të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.456, datë 16.4.2008, vërtetimin e të ardhurave familjare, referuar dokumentacionit të përcaktuar në vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 53 datë 28.1.2005, si më poshtë:

a) Vërtetimi përkatës nga punëdhënësi për vendin e punës/pozicion dhe të ardhurat neto të kryefamiljarit dhe anëtarëve të tjerë të familjes që janë në marrëdhënie pune.

b) Vërtetim nga zyra e ndihmës dhe përkujdesit pranë njësive bashkiake përkatëse për anëtarët e familjes të përfshirë në programin e ndihmës ekonomike dhe të pagesës për personat me aftësi të kufizuar.

c) Vërtetimin nga zyra e punësimit të njësisë vendore përkatëse, për personat e përfshirë në programin e pagesës së papunësisë.

ç) Vërtetim nga organet e sigurimeve shoqërore për personat në pension.

d) Dokumentin nga organet tatimore kur kryefamiljari apo anëtarët e familjes ushtrojnë aktivitet privat.

dh) Deklaratë e noterizuar nga ana e aplikantit, kërkuesit për vërtetësinë e dokumentacionit të paraqitur.

4. Vlera totale e privatizimit të banesës

4.1 Vlera totale e privatizimit të banesës të llogaritet sipas formularit nr.1, bashkëlidhur këtij udhëzimi, sipas formulës.

$$VP= V1+V2+V3+Vt$$

V1=S x K - është kostoja e objektit të vlerësuar, ku:

S- është sipërfaqja totale e ndërtimit të objektit.

K- është kosto lek/m^2 për sipërfaqen e ndërtimit të objektit, referuar me vendimin e Këshillit të Ministrave, nr.815 datë 9.12.1996.

V2- është vlera e shpenzimeve të dokumentacioneve teknike dhe shpenzimeve të regjistrimit të ZRPP sipas faturave.

V3- është vlera e shpenzimeve operacionale në masën 4% të kostos së llogaritur të objektit pa vlerën e truallit.

Vt- është vlera e truallit, llogaritur sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.456, datë 16.4.2008 "Për procedurat e vlerësimit dhe të shitjes, si dhe kriteret e përcaktimit të shitjes së truallit familjeve që përfitojnë banesa me kosto të ulët". Për llogaritjen e vlerës së truallit, sipërfaqja e truallit që privatizohet, të mos jetë më e madhe se sipërfaqja e zënë nga ndërtimi, plus 1m trotuar.

4.2 Për çdo apartament, vlera e privatizimit llogaritet sipas formulari nr.2, bazuar në të dhënat e përgjithshme të formularit nr.1 dhe kuotës së pjesëmarrjes në bashkëpronësi.

5. Lidhja e kontratës, mënyra e likuidimit të pagesës dhe përmbajtja e dosjes

5.1 Çdo qytetar, sipas pikës 2 të këtij udhëzimi, detyrohet të lidhë kontratën e privatizimit me Entin Kombëtar të Banesave, brenda 1 viti nga regjistrimi i pronës në emër të Entit Kombëtar të Banesave në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Në momentin e nënshkrimit të kontratës, qytetari duhet t'i paguajë në mënyrë të menjëhershme Entit Kombëtar të Banesave 4% të vlerës së shpenzimeve operacionale të kryera prej tij.

5.2 Pjesa e mbetur e vlerës së privatizimit pas likuidimit të pagesës së menjëhershme sipas fjalisë së dytë të pikës 5.1 të këtij udhëzimi, mund të shlyhet në mënyrë të menjëhershme nga familja, ose me këste mujore të barabarta, me afat likuidimi deri 25 vjet, me 2% interes në vit.

5.3 Dosja e privatizimit përmban:

a) Kontratën e shitjes së objektit (shitje me rezervë e pronës apo shitje përfundimtare) të lidhur përpara noterit dhe familjareve sipas certifikatës familjare.

b) Formularin nr.1 "Për llogaritjen e treguesve të shitjes së objektit".

c) Formularin nr.2 "Për llogaritjen e çmimit të apartamentit që privatizohet".

ç) Planimetrinë e objektit.

d) Planvendosjen e objektit.

6. Hyrja në fuqi e udhëzimit

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
Sokol Olldashi

ENTI KOMBETAR I BANESAVE **FORMULARI NR. 1**

LLOGARITJA E TREGUESVE TE SHITJES SE BANESES_____
ADRESA _____

1. SIPERFAQJA TOTALE E NDERTIMIT TE BANESES(m2) _____

2. VLERA E SHPENZIMEVE TE BANESES (ne leke)

a) Siperfaqja totale e ndertimit te baneses (m2)(S) _____

b) Kosto e ndertimit l/m2 e vitit 1995, ref. VKM Nr. 815, dt. 09/12/1996 (K) _____

c) Vlera e punimeve te kryera deri 31/12/1992 (V1= axb) _____

d) Vlera e shpenzimeve te dokumentacioneve teknike, si dhe shpenzimeve hipotekore,V2 (sipas fatures EKB-se, leke) _____

SHUMA I _____

2. VLERA E SHPENZIMEVE OPERACIONALE TE ENTIT, V3 (4% e Shumes I ne leke) _____

3. KOSTO PER 1m2 SIP.SHFRYTEZIMI E BANESES(leke/m2)

a) Vlera e shpenzimeve te baneses (Shuma I) _____

b) siperfaqja totale e shfrytezimit(pa sip. totale te bashkepronesise) _____

c) Kostoja l/m2 sip. shfrytezimi e baneses (a/b) _____

4. LLOGARITJA E KOSTOS SE TRUALLIT

a) Siperfaqja totale e truallit ne bashkepronesi _____

b) Siperfaqja totale e ndertimit te baneses ne m2 _____

c) Koeficenti llogarites i truallit (a/b) _____

Data e llogaritjes___/____/_____ Llogaritjet u kryen nga :

1) _____

2) _____

ENTI KOMBETAR I BANESAVE **FORMULARI NR. 2**

LLOGARITJA E CMIMIT TE APARTAMENTIT NR. _____

Banesa _____
Bleresi_____

1. KOSTO E APARTAMENTIT

a) Kosto leke per m2 sip.shfrytezimi e baneses _____
b) Siperfaqja e shfrytezimit e apartamentit m2 _____
c) **Kosto e apartamentit (1ax1b)** leke _____

2. VLERA E TRUALLIT

a) Koeficenti Ilogarites i siperfaqes se truallit _____
b) Siperfaqja e shfrytezimit apartamentit m2 _____
c) Siperfaqja e truallit qe i takon apartamentit (axb) m2 _____
d) Cmimi i truallit leke per m2 (ref VKM Nr.456,dt.16.04.2008) _____
e) **Vlera e truallit (2cx2d) leke** _____

3. VLERA E APARTAMENTIT

a) Kosto e apartamentit ne leke (shuma 1c) _____
b) Vlefta e truallit te apartamentit (shuma 2e) _____
c) **Vlera e apartamentit (3a+3b) leke** _____

4.CMIMI I APARTAMENTIT

a) Kosto e apartamentit (pika 3a) leke _____

Shtohen:

b) Shpenzime operacionale (4% e pikes 3a) leke _____
c) Vlera e truallit (pika 2e) leke _____
Cmimi i apartamentit (4a+4b+4c) leke _____

Nga çmimi zbritet :

d) Diferenca per pagese trualli sipas VKM Nr.456, date 16/04/2008 leke _____

5. Vlera totale per pagese (4a+4b+4c-4d) leke _____

Data e llogaritjes ____./___./_____ *Llogaritjet u kryen nga*

1) _____

2_____

KËRKESË

Kërkuesja Dinora Ibrahimi (Sharkiqi), e bija e Osmanit dhe e Shefikatit, e datëlindjes 13.5.1971, lindur në Shkodër dhe banuese në adresën: lagjja "Salo Alili", rruga "Ali Këlmendi", nr.1027, Shkodër, kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër shpalljen të zhdukur të vëllait të saj, Sadetin Sharkiqi dhe caktimin e saj si kujdestare për administrimin e pasurisë së tij.

KËRKUESJA
Dinora Ibrahimi (Sharkiqi)

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta", mbrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 003.
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2010 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI PENAL	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
PËRMBLEDHJE E AKTEVE NDËRKOMBËTARE PËR DREJTËSINË	660 lekë
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR PASURITË E PALUAJTSHME	328 lekë
PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SHOQËRITË TREGTARE	260 lekë
VENDIME UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË	512 lekë

Hyri në shtyp më 14.10.2010
Doli nga shtypi më 14.10.2010

Tirazhi: 2300 copë	Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2010

Çmimi 36 lekë